

Mbahet në Tiranë Konferenca e Nivelit të Lartë për Reformën në Administratën Publike


Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), mori pjesë në Konferencën e Nivelit të Lartë për reformën në administratën publike, organizuar nën kujdesin e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe projektit EU4GoodGovernance.



Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve publike, ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe partnerë zhvillimi, me qëllim diskutimin e prioriteteve kyçe në avancimin e reformave në administratën publike.

Gjatë punimeve të konferencës u trajtuan, në mënyrë të veçantë, çështje që lidhen me:

- Përmirësimin e sistemeve të vlerësimit të punonjësve;
- Lidhjen e performancës me mekanizmat e shpërblimit financiar dhe jo-financiar;
- Delegimin e përgjegjësi si instrument efektiv i menaxhimit të performancës.





Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në këtë aktivitet, shërben si një mundësi e rëndësishme për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, në funksion të rritjes së efikasitetit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil.